

**PDK-ja mbështet marshin
"Drejtësi, jo politikë!" dhe
nis mobilizimin për
17 shkurt në Prishtinë**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I RI BRENDË NJË MUAJI? HARADINAJ PRITET TA SFIDOJË OSMANIN, POR VOTAT DUKET SE JANË TË PAARRITSHME



Deri më 4 mars Kosova duhet ta ketë presidentin e ri, ose qytetarët e vendit do t'u drejtohen sërish kutive të votimit. Kështu, deputetët e legjislaturës së re të parlamentit, ende të pa

konstituuar, kanë kohë një muaj që ta "shpëtojnë" vendin nga zgjedhjet e reja. Lideri i kësaj të fundit, Albin Kurti, tashmë ka përsëritur disa herë deklaratën që duhet diskutime

edhe me partitë e tjera. Në anën tjetër brenda AAK-së kanë vlerësuar se lideri i tyre, Ramush Haradinaj, është një prej kandidatëve "më të denjë" që ka vendi për këtë pozitë

**KURTI: PO
PËRGATITEMI TË
KONSTITUOJMË
KUVENDIN DHE
SA MË SHPEJT
EDHE QEVERINË**

F. 3



**HAMZA, ABDIXHIKU DHE GJINI TAKOJNË DELEGACIONIN
SLOVEN: KOSOVA KA NEVOJË PËR MBËSHTETJE TË
KOORDINUAR NDËRKOMBËTARE**

F. 3



AKTUALE



**BISEDIME UKRAINË - RUSI NË ABU
DABI TEKSA MOSKA KRYEN SULME
TË REJA**

F. 2

**MPB DHE POLICIA NISIN FUSHATËN
INFORMUESE PËR LIGJIN
PËR TË HUAJT DHE LIGJIN
PËR AUTOMJETE**

F. 3

**VIRUSI NIPAH, RAMADANI:
RREZIKU PËR KOSOVËN ËSHTË
SHUMË I ULËT**

F. 7

EKONOMI



**NË ERRËSIRË, KOSOVA HUMBET
RRUGËN DREJT ENERGJISË SË
RIPËRTËRISHME**

F. 8

SPORT



**FFK-ja SOT MBAN KUVENDIN
ZGJEDHOR, ADEMI PRITET
TË RIZGJEDHET PRESIDENT**

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BISEDIME UKRAINË - RUSI NË ABU DABI TEKSA MOSKA KRYEN SULME TË REJA

KIEV, 4 SHKURT - Bisedimet e paqes në mes të Ukrainës dhe Rusisë, të ndërmjetësuara nga Shtetet e Bashkuara, kanë nisur në Emiratet e Bashkuara Arabe, disa orë pasi forcat ruse kryen sulme të reja në mbarë Ukrainën. Negociatat e drejtpërdrejta në mes të Moskës dhe Kievit, me përfshirjen e përfaqësuesve amerikanë, rifilluan në Abu Dabi më 23-24 janar. Takimet në mes të negociatorëve ukrainas dhe rusë kanë qenë të rralla që kur Moska nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Negociatori kryesor i Ukrainës,

Rustem Umerov, konfirmoi në X se negociatat kanë nisur, duke thënë se negociatorët nga Ukraina, Rusia dhe ShBA-ja kanë nisur takimin në formatin trepalësh. “Më pas vjen puna e grupeve të ndara sipas temave të caktuara pas të cilave është planifikuar sinkronizimi i përbashkët i qëndrimeve”, shtoi ai. Sipas raportimeve të mëhershme të medie, që cituan një zyrtar të pidentifikuar të Shtëpisë së Bardhë, i dërguari i posaçëm i presidentit Donald Trump, Steve Witkoff, do ta përfaqësojë Uashingtonin në negociatat në mes të Ukrainës dhe Rusisë.



Shpresat janë të pakta për ndonjë përparim drejt përfundimit të luftës që ka nisur pothuajse katër vjet më parë dhe zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, u tha gazetarëve më herët gjatë 4

shkurtit se pozicioni i Rusisë në bisedime mbetet i pandryshuar dhe se “është absolutisht e qartë dhe këtë e dinë negociatorët e Kievit dhe ata amerikanë”. Bisedimet vijnë disa orë pasi Rusia kreu një sulm masiv me raketa dhe dronë që goditën kryeqytetin ukrainas, Kiev, dhe rajonet e tjera në mbarë Ukrainën. Zyrtarët ukrainas thanë se këto janë taktika të njohura të Kremlinit që përdor diplomacinë për të blerë kohë dhe njëkohësisht intensifikon sulmet. Forcat ruse kanë sulmuar Ukrainën gjatë natës me më shumë se 100 dronë,

raportuan Forcat Ajrore ukrainase më 4 shkurt. Në rajonin e Dnipropetrovskut, dy persona u vranë dhe dy të tjerë u plagosën si pasojë e një sulmi me dronë, sipas autoriteteve rajonale. “Një grua 68-vjeçare dhe një burrë 38-vjeçar u vranë” në sulmin ndaj rajonit të Dnipropetrovskut, shkroi në Telegram Mykola Lukashuk, kreu i administratës rajonale. Në rajonin jugor të Odesës, të paktën pesë persona u plagosën nga një sulm ruse gjatë natës, thanë autoritetet rajonale, duke shtuar se u dëmtuan shtëpi, kopshte fëmijësh dhe një shkollë.

SHBA-JA DHE INDIA U JAPIN FUND RAPORTEVE TË FTOHTA



UASHINGTON, 4 SHKURT - Lajmet e fundit nga Uashingtoni mund të shihen anembanë në Indi: ShBA-ja dhe India kanë arritur një marrëveshje historike tregtare. Vetëm pak kohë pas marrëveshjes me BE-në, çuditërisht shpejt, e ndoshta jo edhe rastësisht, arrihet marrëveshja me tyre. Marrëveshja u njoftua në mënyrën tipike nga Trumpi, në Truth Social, platformën e Presidentit amerikan. Donald Trump njoftoi se ShBA-ja do t'i ulë ndjeshëm tarifën doganore për mallrat e Indisë: nga 50 për qind në 18 për qind. Një tarifë ndëshkuese e vendosur më parë

prej 25-përqindësh do të eliminohet plotësisht, sipas burimeve nga Shtëpia e Bardhë. ShBA-ja e kishte vendosur këtë tarifë, sepse India vazhdoi të blinte naftë dhe gaz rus të lirë pavarësisht prej sanksioneve perëndimore. Një tarifë shtesë, e përgjithshme, do të ulet gjithashtu nga 25 për qind në 18 për qind.

Marrëdhëniet e ftohura në mes të ShBA-së dhe Indisë

Marrëdhënia midis kryeministrit

të Indisë Narendra Modi dhe Trumpit konsiderohej se ishte ftohur ndjeshëm kohët e fundit. Tarifat drastike të ShBA-së kishin tensionuar marrëdhëniet dhe një marrëveshje dukej më pak e mundur, por tani më nuk flitet për një atmosferë të ftohtë në kampin amerikan. Në vend të kësaj, ambasadori amerikan Sergio Gor theksoi afërsinë personale midis dy udhëheqësve në kanalin e lajmeve NDTV në Indi. “Gjithmonë kam thënë se kryeministri dhe presidenti ndajnë një miqësi të ngushtë. Disa nuk e besuan, por kjo miqësi është rritur gjatë shumë viteve, ka vazhduar dhe në fund të fundit është arsyeja pse u arrit kjo marrëveshje”, tha Gor.

Ndalimi i importit si levë kundër Rusisë?

Vetëm miqësia me sa duket nuk e shpjegon marrëveshjen. Siç deklaroi Trump, Modi kishte rënë dakord më parë të mos importonte më naftë nga Rusia. Ambasadori amerikan

Gor nuk deshi t'i komentojë hollësitë e marrëveshjes. Mjafton të thuhet se të dyja palët kanë rënë dakord prej kohësh për dëshirën për t'i dhënë fund luftës midis Rusisë dhe Ukrainës. “Kryeministri gjithashtu dëshiron të shohë paqe atje, ashtu si edhe presidenti”, theksoi Gor. Prandaj, marrëveshja e arritur tani është një shkak për festim. Gor shtoi: “Për ta kuptuar më mirë, dua t'ju kujtoj se Bashkimit Evropian dhe Indisë iu deshën 19 vjet për të negociuar marrëveshjen e tyre”. Megjithatë ekspertët e konsiderojnë të pamundur që India t'i ndërpresë menjëherë të gjitha blerjet e naftës bruto nga Rusia. Në një reagim në platformën X, kryeministri Modi shprehu kënaqësinë e tij për uljet e tarifave. Ai ende nuk ka komentuar të dhënat për blerjen e naftës ruse. Ministri i Tregtisë i Indisë, Piyush Goyal, deklaroi se marrëveshja do të krijojë lidhje më të ngushta midis dy ekonomive dhe do të krijojë

mundësi të papara për kompanitë indiane. Sipas presidentit të ShBA-së, Trump, India po angazhohet t'i ulë tarifën e importit për mallrat amerikane në zero dhe të importojë produkte me vlerë 500 miliardë dollarë.

India është hapur

Për ekspertin e tregut financiar Arvind Sanger, pakti tregtar ka implikime afatgjata: “Në vitet e fundit India ka hezituar ta marrë riskun e hyrjes në marrëveshje të tregtisë së lirë. Vetëm pak muaj më parë vendi mezi ishte i pranishëm në shumë marrëveshje ndërkombëtare tregtare”, shpjegon ai. Tani India është hapur dukshëm më shumë - “me BE-në, me Britaninë e Madhe dhe tani përsëri edhe me ShBA-në. Nga një perspektivë afatgjatë, kjo është me rëndësi të madhe”. Pak më shumë se një javë më parë, BE dhe India arritën një marrëveshje të gjerë që eliminon tarifën për pothuajse të gjitha mallrat.

GJERMANIA ‘NË OFENSIVË’, MERZ ‘FARKËTON’ ALEANCA ME VENDET E GJIRIT PERSIK

BERLIN, 4 SHKURT - Brenda 72 orësh kancelari gjerman Friedrich Merz do të vizitojë tri shtete në rajonin e Gjirit Persik, në të njëjtën kohë që kërkon “partneritete të reja strategjike” me Indinë. Mes luhatjeve që po pëson miqësia me ShBA-në, Gjermania po farkëton aleanca të tjera. Lidhjet e qeverisë gjermane me

shtetet kyçe të rajonit: Arabia Saudite, Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe janë gjithmonë e më të dukshme. Ndërkohë që në Arabinë Saudite ndodhej ministri i Mjedisit, socialdemokrati Carsten Schneider, zbriti në tokë edhe avioni me ministren e Ekonomisë, kristiandemokraten Katherina Reiche, në bord, e cila

vuri në dukje se: “Nëse partneritetet, tek të cilat ke pasur besim dekada të tëra, fillojnë të pësojnë krisje, duhet të kërkojmë partnerë të rinj”. Fokusi i kërkimit të partnerëve është në fushën e energjisë dhe projektet e armatimit. Nga 4 deri më 6 shkurt kancelari Merz udhëton fillimisht për në Arabinë Saudite për të vazhduar në Katar

e në fundjavë në Emirate. Të gjitha këto brenda 72 orësh. Synimi është të shtohen kontaktet ekonomike dhe për marrëveshje të qëndrueshme, në një kohë kur është gjithnjë e më pak është e qartë, se sa Evropa dhe Gjermania mund të vazhdojnë të mbështeten te partnerë deri tani të rëndësishëm si ShBA-ja.



HAMZA, ABDIXHIKU DHE GJINI TAKOJNË DELEGACIONIN SLOVEN: KOSOVA KA NEVOJË PËR MBËSHTETJE TË KOORDINUAR NDËRKOMBËTARE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesin Special të Sllovenisë për Ballkanin Perëndimor, ambasadorin Anzej Franges. Gjatë takimit Hamza shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Sllovenisë ndaj Kosovës, duke vlerësuar rolin konstruktiv të partnerëve ndërkombëtarë në proceset e dialogut dhe në ruajtjen e stabilitetit rajonal. “Ne diskutuam edhe për rëndësinë e një qasjeje të koordinuar ndërmjet BE-së dhe ShBA-së për forcimin e paqes dhe sigurisë në Ballkanin Perëndimor”, ka shkruar Hamza. Ai Hamza theksoi se Kosova ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme dhe për procese të drejta, gjithëpërfshirëse dhe të orientuara drejt rezultateve konkrete, në funksion të stabilitetit afatgjatë dhe integritetit euroatlantik të

vendit.

Takim me Frangesin ka zhvilluar edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku. LDK-ja ka njoftuar se gjatë

takimit u diskutua lidhur me situatën aktuale politike në vend, sfidat me të cilat po përballlet Kosova, si dhe qëndrimet dhe vlerësimet e LDK-së karshi kësaj situatë

dhe zhvillimeve të përgjithshme politike. Abdixhiku shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme dhe të pakursyer që Sllovenia i

ka dhënë Kosovës ndër vite, duke e vlerësuar atë si një partnere të rëndësishme për Kosovën në proceset integruuese euroatlantike. Edhe nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini, ka pritur në takim delegacionin sloven, i përbërë nga Anzej Franges, përfaqësues special i Republikës së Sllovenisë për Ballkanin Perëndimor, Borut Blaj, ambasador i Republikës së Sllovenisë në Kosovë, si dhe Eliška Kersnic Zmavc, shefe e Departamentit për Zgjerim dhe Evropën Juglindore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Sllovenisë. Gjatë takimit u diskutua për zhvillimet aktuale politike në Kosovë dhe rajon, sfidat me të cilat përballlet vendi, si dhe për marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë. Nënkrjetari Gjini vlerësoi lart përkrahjen e vazhdueshme dhe të pakursyer të Republikës së Sllovenisë për Kosovën, veçanërisht në proceset integruuese dhe në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar.



MPB DHE POLICIA NISIN FUSHATËN INFORMUESE PËR LIGJIN PËR TË HUAJT DHE LIGJIN PËR AUTOMJETE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 SHKURT - Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës, po vazhdon aktivitetet informuese në kuadër të procesit të zbatimit të Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjete. Këto aktivitete po realizohen edhe përmes shpërndarjes së broshurave informuese për qytetarët. Fushata informuese po zhvillohet në të gjitha pikat kufitare të Republikës së

Kosovës, si dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, me qëllim të informimit të qytetarëve për zbatimin e këtyre dy ligjeve. Qëllimi i kësaj fushate është informimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve lidhur me procedurat ligjore për hyrje, qëndrim dhe punësim në Republikën e Kosovës, si dhe për rregullat dhe obligimet që kanë të bëjnë me drejtimin dhe qarkullimin e automjeteve në territorin e vendit. Ministria e Punëve të Brendshme, përmes të gjitha mekanizmave në dispozicion, po



zhvillon një fushatë të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse përmes formave të ndryshme të

kommunikimit, me synimin që mesazhet kryesore lidhur me hyrjen në fuqi të këtyre ligjeve

të arrijnë te të gjithë qytetarët. Fushata informuese do të vazhdojë deri më 15 mars 2026, me synimin për të lehtësuar qasjen në informata dhe për të siguruar respektimin e legjislacionit në fuqi. Ministria e Punëve të Brendshme ka falënderuar Policinë e Kosovës dhe të gjithë zyrtarët e angazhuar për profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar gjatë realizimit të kësaj fushate si dhe shpreh mirënjohje për qytetarët për bashkëpunimin e tyre.



PRESIDENTI I RI BRENDË NJË MUAJI? HARADINAJ PRITET TA SFIDOJË OSMANIN, POR VOTAT DUKET SE JANË TË PAARRITSHME

Deri më 4 mars Kosova duhet ta ketë presidentin e ri, ose qytetarët e vendit do t'u drejtohen sërish kutive të votimit. Kësisoj, deputetët e legjislaturës së re të parlamentit, ende të pa konstituuar, kanë kohë një muaj që ta "shpëtojnë" vendin nga zgjedhjet e reja. Lideri i kësaj të fundit, Albin Kurti, tashmë ka përsëritur disa herë deklaratën që duhet diskutime edhe me partitë e tjera. Në anën tjetër brenda AAK-së kanë vlerësuar se lideri i tyre, Ramush Haradinaj, është një prej kandidatëve "më të denjë" që ka vendi për këtë pozitë.

PRISHTINË, 4 SHKURT - Deri më 4 mars Kosova duhet ta ketë presidentin e ri, ose qytetarët e vendit do t'u drejtohen sërish kutive të votimit. Kësisoj, deputetët e legjislaturës së re të parlamentit, ende të pa konstituuar, kanë kohë një muaj që ta "shpëtojnë" vendin nga zgjedhjet e reja. Megjithatë, edhe pse mund të tingëllojë si proces i thjeshtë, në fakt, e çështja është më e komplikuar se kaq. Arsyeja për këtë është se duhen së paku 80 vota gjatë zgjedhjes së kryetarit të shtetit. Pikërisht kjo arsyeje, dhe qëndrimet e "mjegullta" të partive, kanë bërë që njohësit të aludojnë se gjasat më të mëdha janë zgjedhjet e

reja, që do të ishin të pstat brenda 13 muajve. Vjosa Osmani, ajo që mban ende këtë pozitë, pesë vjet më parë gëzoi përkrahje të madhe nga deputetët. Porse ky fundmandatat, e gjen atë në një situatë tjetër. Përderisa ajo tashmë ka deklaruar haptazi se dëshiron sërish pozitën e të parës së vendit, qëndrimet e partive, përfshirë edhe ata që e përkrahën fuqishëm atë pesë vite më parë, Lëvizjes Vetëvendosje, s'janë të qarta. Lideri i kësaj të fundit, Albin Kurti, tashmë ka përsëritur disa herë deklaratën që duhet diskutime edhe me partitë e tjera. Jozyrtarisht, spekulohet se Kurti i ka thënë Osmanit se ai do t'ia siguronte votat e LV-së nëse

ajo i siguron e tjerat. Merret vesh se Osmani tashmë ka filluar të kontaktojë deputetë. Qëndrime se "duhet diskutime e konsensus" kanë edhe partitë e tjera. Partia Demokratike e Kosovës e Lidhja Demokratike e Kosovës janë dy partitë që kanë bërë thirrje të tilla për marrëveshje politike e kandidat konsensual. Porse partia e katërt, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka "marrë një rrugë tjetër". Kjo parti po shtyn përpara idenë se lideri i saj, Ramush Haradinaj, duhet ta gëzojë pozitën e presidentit. Përvoja si ish-kryeministër, e një nga figurat më të rëndësishme të UÇK-së, janë gjërat në cilat aludohet se Haradinaj, do të ishte figura më e mirë konsensuale për president, sipas tyre. Vetë Haradinaj, i cili deri tani është kandidati i vetëm që po sfidon Osmanin, nga ana e opozitës, është duke zhvilluar vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vitet e fundit ai është thirrur në forcimin e marrëdhënieve të Kosovës me ShBA-në për të cilat ka pasur kritika se kohëve të fundit s'janë të mira. Anëtar i partisë së tij, Besnik

Tahiri, në një lidhje direkte nga ShBA-ja, ka vlerësuar se Haradinaj është një prej kandidatëve "më të denjë" që ka vendi për këtë pozitë. "Normal se nuk ka qenë një ambicie e fshehur e z. Haradinaj për këtë, por kjo nuk varet as nga Amerika, as nga kongresi, as kurrfarë lidhje, kjo varet nga vetëdija politike e një vendi, në qoftë se ka vetëdije politika brenda kuvendit, unë mendoj që z. Haradinaj është një nga kandidatët më të denjë që ka Kosova", ka deklaruar ai. Ai ka paralajmëruar konsultime me PDK-në e LDK-në për këtë çështje. Haradinajn për president si kandidat "serioz" e ka vlerësuar edhe Lulzim Peci. Ky i fundit, në RTV21, ka thënë se këtë vlerësim e ka duke u "bazuar edhe në të kaluarën". Ndërkaq për Osmanin, ai ka thënë se presidentja "ndihet e pasigurt". "Vjosa Osmani ndihet e pasigurt që do propozohet për presidente të vendit, Ramush Haradinaj është kandidat serioz për postin e presidentit, duke u bazuar edhe në të kaluarën, por problem nuk do të jetë mbledhja e votave, por problem i tij është votimi. Nuk besoj që LV-ja do ta

votojë, në anën tjetër mund të shërbejë që në sallë do të jenë 80 deputetë", ka deklaruar Peci. Për çështjen e presidentit ka pasur deklarime të shumta. Megjithatë, deklaratimet kanë qenë më shumë rreth situatës në të cilën do të gjendet vendi pas 4 marsit: Me presidentin të ri, apo me zgjedhjet e reja. Një koment ndryshe ka dhënë Blerim Shala, i cili, në një opinion të tijin, ka deklaruar prerazi, se vendit nuk i duhen zgjedhjet e reja, duke shtuar se "këtë duhet thënë troç që të gjithë ne: qytetarët dhe politikanët e Kosovës". Në shkrimin e tij, ai ka shtuar edhe se partitë duhet të kenë "diskutim të ndershëm" për zgjedhjen e presidentit /presidentes së Kosovës. Procesi i zgjedhjes së presidentit/es të ri/të re mund të zhvillohet deri në tri faza ose raunde. Në dy raundet e para është e domosdoshme që në sallë të jenë së paku 80 deputetë, ndërsa në raundin e tretë mjafton edhe shumica e thjeshtë. Për të qenë kandidat, një person duhet të sigurojë 30 nënshkrime të deputetëve, nga 120 sa janë. /GazetaExpress



PDK-ja MBËSHTET MARSHIN “DREJTËSI, JO POLITIKË!” DHE NIS MOBILIZIMIN PËR 17 SHKURT NË PRISHTINË

PRISHTINË, 4 SHKURT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka shprehur mbështetjen e saj për marshin qytetar “Drejtësi, jo politikë!”, i cili do të organizohet nga platforma “Liria ka Emër” më 17 shkurt, në Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në Prishtinë. Partia Demokratike e Kosovës

ka njoftuar se ka nisur mobilizimin e saj në të gjitha strukturat partiake, anembanë Kosovës, me qëllim të angazhimit sa më të gjerë të qytetarëve për pjesëmarrje masive në këtë marsh qytetar. “PDK-ja vlerëson se ky marsh është thirrje e ligjshme dhe paqësore për drejtësi të paanshme, në mbrojtje të

luftës çlirimtare të Kosovës dhe të luftëtarëve të lirisë, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe bashkëluftëtarëve të tyre, të cilët po përballen me procese gjyqësore në Hagë. Në këtë periudhë kur procesi ka hyrë në fazën përmbyllëse, PDK-ja kërkon drejtësi të plotë, të barabartë dhe larg çdo ndikimi

politik. “Partia Demokratike e Kosovës rithekson se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë e drejtë dhe çlirimtare, e lindur nga nevoja për liri dhe dinjitet. Çdo përpjekje për ta relativizuar këtë të vërtetë historike përbën padrejtësi ndaj sakrificës së popullit të Kosovës”, është thënë në njoftimin e PDK-së.

Partia Demokratike e Kosovës ka ftuar qytetarët që në frymën e unitetit dhe respektit institucional, të bashkohen më 17 shkurt në Prishtinë për të kërkuar drejtësi dhe për ta nderuar sakrificën çlirimtare mbi të cilën është ndërtuar Republika e Kosovës. “Drejtësi, jo politikë!”, theksohet në njoftimin e PDK-së.

KURTI: PO PËRGATITEMI TA KONSTITUOJMË KUVENDIN DHE SA MË SHPEJT EDHE QEVERINË



PRISHTINË, 4 SHKURT - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se kabineti qeveritar i tij do t'i ketë shumë prej emrave që i kishte paraqitur vetë ai si mandatar për kryeministër dhe Glauk Konjufca, por që nuk morën votat e mjaftueshme. Kurti ka përmendur rëndësinë

që sa më shpejt të formohen institucionet e vendit, në mënyrë që Kuvendi t'i miratojë edhe marrëveshjet ndërkombëtare me Bankën Botërore, Planin e Rritjes me Bashkimin Evropian dhe buxhetin e Kosovës, e për këtë të fundit thekson se nuk mund të vazhdohet me 1/12 edhe në

muajin mars. “Do të ketë shumë prej emrave që tashmë i kam prezantuar unë dhe Glauk Konjufca vjeshtën e vitit të kaluar, mirëpo nuk do të jenë identikë. Do të ketë edhe emra të tjerë. Ne po përgatitemi që së pari ta konstituojmë Kuvendin dhe sa më shpejt ta formojmë qeverinë sepse, siç e

dini, kemi tri marrëveshje ndërkombëtare me Bankën Botërore, njëkohësisht e kemi edhe planin e rritjes me Bashkimin Evropian, që është 882.6 milionë euro dhe që duhet sa më parë ta miratojmë në Kuvendin e Republikës, pa harruar që kemi më së shumti përgjegjësi, obligim, por do të

thosha edhe preferencë, e ky është buxheti për vitin 2026. Ju e dini që me 1/12 qeveria në detyrë mund të vazhdojë veç edhe për muajin shkurt, për muajin mars nuk mund të vazhdohet kështu. Andaj, në muajin shkurt duhet ta kemi të përmbyllur edhe çështjen e buxhetit”, ka thënë Kurti.

ZKA-ja auditon Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve të UP-së

PRISHTINË, 4 SHKURT - Në kuadër të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimit 2025/2026, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është duke e realizuar auditimin “Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS)” në Universitetin e

Prishtinës”. Auditimi do të vlerësojë menaxhimin dhe administrimin e platformës SEMS, si dhe nëse kjo platformë siguron mbështetje efektive dhe të sigurt për funksionet kryesore të

Universitetit të Prishtinës. Universiteti i Prishtinës ka krijuar platformën SEMS për t’u ofruar shërbime elektronike studentëve që nga procesi i aplikimit për studime deri te pajisja me diplomë. SEMS është në

përdorim që nga viti 2012 dhe funksionon në të gjitha njësitë akademike të UP-së duke mbuluar gjithsej 14 fakultete. SEMS ka rol kyç në efikasitetin dhe transparencën e menaxhimit akademik dhe administrativ të UP-së.



VENDOSJET PLLAKA PËRKUJTIMORE PËR VIKTIMAT E ‘NATËS SË TMERRIT’




MITROVICË, 4 SHKURT - Të mërkurën është bërë zbulimi i pllakës përkujtimore në urën e re mbi lumin Ibër në Mitrovicë, me rastin e shënimit të Natës së Tmerrit të 3 dhe 4 shkurtit 2000, në nderim dhe kujtim të 10 shqiptarëve të vrarë, të plagosur 25 të tjerë dhe rreth 12 000 banorë që u detyruan t’i lëshojnë shtëpitë e tyre në veri. Në ceremoninë përkujtimore morën pjesë kryetari i komunës së Mitrovicës, Faton Peci, nënkryetari Enis Osmani, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryesuesi i Kuvendit, Safet Kamberi, drejtorë të drejtorive komunale, familjarë dhe qytetarë tjerë. Me këtë rast, kryetari Faton Peci theksoi se

vendosja e pllakës përkujtimore ka për qëllim që sakrificat dhe gjaku i derdhur i qytetarëve shqiptarë të mos harrohen kurrë. Ai nënvizoi se mesazhi që përcillet është se për lirinë e Kosovës është dhënë gjak edhe pas çlirimit të saj, duke shtuar se viktimat ishin civilë të pafajshëm, të pambrojtur, të vrarë vetëm pse ishin shqiptarë dhe pse ishin rikthyer në shtëpitë dhe pronat e tyre. “Pllaka përkujtimore, e vendosur në urën e re për këmbësorë, shërben si kujtesë e përhershme për brezat e ardhshëm mbi çmimin e lirisë dhe nevojën që krimet e kryera të mos harrohen kurrë”, është shprehur kryetari Peci.

ARRESTOHEN TRE PERSONA TË DYSHUAR PËR KRIM TË ORGANIZUAR

PRISHTINË, 4 SHKURT - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka arrestuar tre persona të dyshuar për krim të organizuar. Të dyshuarit F. M., V. M. dhe A. D. po hetohen për veprat penale “Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”, në lidhje me veprat penale “Mashtrimi” dhe “Hyrjen në sistemet kompjuterike”, sipas nenit 327, paragrafi 2 të KPRK-së. Sipas hetimeve që janë duke u zhvilluar në koordinim me Policinë e Kosovës në këtë rast, i cili ka edhe element ndërkombëtar, të pandehurit

dyshohet se nga viti 2021 e tutje, në bashkëkryerje me persona të tjerë, janë paraqitur rrejtshëm si punëtorë bankash. Dyshimet përfshijnë veprat penale të mashtimit, prezantimit të rremë, vjedhjes së identitetit dhe kredencialeve, si dhe shpëlarjes së parave, me qëllim përfitimi të drejtpërdrejtë financiar. Gjatë zbatimit të urdhër-kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar prova materiale, përfshirë telefona, një veturë, laptopë dhe para të gatshme në vlerë prej 11 756 eurosh.



AGK-ja nderohet me mirënjohje nga Policia e Kosovës



PRISHTINË, 4 SHKURT - Në ceremoninë e Policisë së Kosovës, të mbajtur me rastin e prezantimit të raportit të punës për vitin 2025 të Drejtorisë Rajonale të Prishtinës, u nda një mirënjohje për Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës. Përmes kësaj mirënjohjeje u

vlerësua bashkëpunimi ndërmjet AGK-së dhe Policisë së Kosovës, përkatësisht Drejtorisë Rajonale të Prishtinës, si dhe kontributi i vazhdueshëm i gazetarëve në informimin e saktë dhe të paanshëm të publikut. Mirënjohjen e pranoi drejtoresha ekzekutive e AGK-së, Getoarë

Mulliçi. AGK-ja e vlerëson bashkëpunimin me Policinë e Kosovës dhe rithekson angazhimin e saj për t’i inkurajuar gazetarët që t’i raportojnë të gjitha rastet e shkeljeve dhe cenimeve gjatë ushtrimit të profesionit.

Nënshkruhet plani vjetor i bashkëpunimit Kosovë - Austri në mbrojtje

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 SHKURT - Në Ministrinë e Mbrojtjes është zhvilluar takimi bilateral me delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës Federale të Austrisë, ku palët kanë nënshkruar Planin Vjetor të Bashkëpunimit Bilateral për vitin 2026, dokument i cili përcakton aktivitetet konkrete dhe fushat e angazhimit të përbashkët në fushën e

mbrojtjes. Drejtori i Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, kolonel Ahmet Ajeti, së bashku me zyrtarë të këtij Departamenti priti delegacionin austriak të kryesuar nga gjeneralbrigade Nikoluas Rottenberger, udhëheqës i Divizionit të Diplomacisë Ushtarake. Gjatë qëndrimit në Ministrinë e Mbrojtjes, delegacioni austriak u takua me drejtorin e Politikave të Mbrojtjes,

Faruk Gecin, ku u diskutua përparimi i bashkëpunimit ekzistues si dhe objektivat dhe prioritetet e përbashkëta për të ardhmen. Republika Federale e Austrisë mbetet partnere dhe kontribuuese e rëndësishme në zhvillimin dhe stabilitetin e Republikës së Kosovës dhe të rajonit, ndërsa bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy vendeve po shënon zhvillim të vazhdueshëm.



VIRUSI NIPAH, RAMADANI: RREZIKU PËR KOSOVËN ËSHTË SHUMË I ULËT

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHKURT - Mjeku Naser Ramadani ka reaguar lidhur me shqetësimet për virusin Nipah, duke theksuar se qytetarët duhet të qëndrojnë të informuar dhe jo të frikësuar. Ai sqaron se, ndonëse virusi ka shkallë të lartë vdekshmërie, shpërthimet janë të rralla dhe të kufizuara në disa zona të Azisë. Sipas tij, rreziku për Kosovën, Shqipërinë dhe rajonin mbetet shumë i ulët. “Virusi Nipah ngjall shqetësim global, ndërsa shkencëtarët paralajmërojnë për rrezik të lartë! Virus i Nipah është rikthyer në vëmendjen e publikut, duke ngritur pyetje nëse bota duhet të shqetësohet. Ekspertët e shëndetit publik theksojnë se Nipah është i rrallë, por kur ndodhin shpërthime,



pasojat mund të jenë shumë të rënda. Ajo që e bën veçanërisht shqetësues është shkalla e lartë e vdekshmërisë, e cila në shpërthimet e kaluara ka qenë nga 40% deri në 75%”, ka shkruar Ramadani në “Facebook”. A duhet të shqetësohet bota?, ka pyetur Ramadani. “Qëndroni të informuar, jo të frikësuar. Disa të

dhëna të përgjithshme për të informuar qytetarët që të mos bien pre e dezinformimeve të ndryshme dhe për të mos shkaktuar panik të panevojshëm! Nipah është një virus që mund të kalojë nga kafshët te njerëzit. Burimet më të shpeshta të infeksionit janë lakuriqët e

frutave (Familja Pteropodidae) të cilat lloje nuk gjenden te ne! Lakuriqët në Shqipëri dhe Kosovë quhen hundëpatkua i vogël (Rhinolophus hipposideros) dhe janë insektivore, që do të thotë se ushqehen kryesisht me insekte dhe molusqe të vogla dhe nuk hanë fruta. Aktualisht virusi nuk përhapet përmes ajrit”, ka thënë Ramadani. Ai ka treguar për simptomat e këtij virusi. “Ethe, dhimbje koke, konfuzion, vështirësi në frymëmarrje, lodhje, marramendje, të vjella, diarre; Sëmundja mund të përkeqësohet dhe të shkaktojë ënjtje të trurit (encefalit) dhe vdekje; Rreth 20 % e të mbijetuarve mund të kenë probleme neurologjike afatgjata”. Ndërkaq për diagnostikim

duhet të bëhen testet kryesore RT-PCR dhe testet e antitropave (ELISA). “Trajtimi: Nuk ka terapi ose vaksinë të miratuar. Trajtimi është mbështetës: oksigjenim, hidratim, kujdes për funksionimin normal të organizmit Parandalimi: Mos konsumoni fruta ose lëngje që mund të jenë prekur nga lakuriqët; Përdorni doreza dhe mbrojtje kur trajtoni kafshët e sëmura; Evitoni kontakt të afërt me njerëzit e sëmurë dhe mbani higjienën e duarve. Në spitale: pacientët duhet të izoloohen, stafi të përdorë maska, doreza, mantila dhe syze mbrojtëse. Rreziku aktual: Deri tani shpërthimet janë të kufizuara në disa zona të Azisë. Shumë i ulët rreziku për Europën, Ballkanin, Kosovën dhe Shqipërinë”, ka deklaruar mjeku Ramadani.

GAZMEND MUHAXHERI MBËSHTET MARSHIN ‘DREJTËSI, JO POLITIKË’ MË 17 SHKURT

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PEJË, 4 SHKURT - Përfaqësuesit e platformës “Liria ka Emër”, Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, kanë vizituar komunën e Pejës, në të cilën janë pritur në takim nga kryetari i komunës, Gazmend Muhaxheri, i cili ka shprehur mbështetje për marshin “Drejtësi, jo politikë”, që do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbrojtje të drejtësisë së paanshme dhe të vlerave të luftës çlirimtare. Gjatë takimit përfaqësuesit e

platformës paraqitën aktivitetet dhe angazhimin e tyre në kuadër të fushatës së mobilizimit qytetar, duke shprehur mirënjohje për përkrahjen e ofruar nga komuna e Pejës. “Mbështetja që po marrim nga komunat dhe kryetarët e tyre dëshmon se kjo kauzë i tejkalon dallimet dhe buron nga vetë ndërgjegjia qytetare”, ka thënë Hoxha. Ndërkaq Ismail Tasholli theksoi se ky marsh nuk organizohet kundër askujt, por si thirrje qytetare në mbrojtje të drejtësisë dhe parimeve të saj. “Marshi ‘Drejtësi, jo politikë’ është thirrje



paqësore për respektimin e parimeve të drejtësisë, dinjitetit njerëzor dhe për ndarjen e qartë të drejtësisë nga politika”, ka

thënë Tasholli. Nga ana e tij, kryetari i komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, theksoi rëndësinë e pjesëmarrjes

qytetare dhe u zotua për angazhim në mobilizimin e qytetarëve. “Kjo është një thirrje që meriton mbështetje të gjerë qytetare. I ftoj qytetarët e Pejës dhe të gjithë Kosovës që më 17 shkurt të bashkohen në Prishtinë për të kërkuar drejtësi”, ka thënë Muhaxheri. Platforma “Liria ka Emër” do t’i vazhdojë takimet dhe aktivitetet në të gjitha komunat e Kosovës dhe me aktorë të ndryshëm shoqërorë, me synim të mobilizimit sa më të gjerë qytetar për Marshin e 17 shkurtit, me moton “Drejtësi, jo politikë”.

Haradinaj takon kongresistin republikan, kërkon mbështetjen e Trumpit për anëtarësimin e Kosovës në NATO

PRISHTINË, 4 SHKURT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, gjatë qëndrimit të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ka

zhvilluar takim me kongresistin republikan nga Teksasi, Pete Sessions. Haradinaj këtë e bëri me dije përmes një postimi në rrjetin social në “Facebook” se gjatë vizitës në Kongresin

Amerikan ka kërkuar mbështetjen e presidentit Donald Trump dhe të Kongresit Amerikan për anëtarësimin e Kosovës në NATO. “Gjatë vizitës në Kongresin Amerikan, kam

kërkuar mbështetjen e Presidentit Trump dhe të Kongresit Amerikan për anëtarësimin e Kosovës në NATO. Këtë çështje e kam adresuar në një takim me kongresistin republikan nga



Teksasi, Pete Sessions”, ka shkruar Haradinaj.

NË ERRËSIRË, KOSOVA HUMBET RRUGËN DREJT ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME

PRISHTINË, 4 SHKURT - Gjashtëqind mijë tonë. Kaq qymyr nxjerr për afërsisht Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në muaj. Por kjo sasi e nxjerrë e përpunuar dhe transformuar në energji elektrike nuk ka mjaftuar në dimrat e fundit për t'i mbuluar nevojat e konsumatorëve në Kosovë, pasi që pothuajse gjithë barrën për furnizim me energji elektrike e mbajnë mbi supe dy termocentralet e vjetruara, Kosova A dhe Kosova B. Sipas statistikave të fundit, nga nëntori i vitit të kaluar vetëm rreth 11 për qind e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë vjen nga burime të ripërtërishme si uji, era dhe dielli.

Një inxhinier i KEK-ut tregoi për Radion Evropa e Lirë se pavarësisht se a nxirret më shumë qymyr nga miliarda tonët në dispozicion, dy termocentralet nuk kanë kapacitet të prodhojnë më shumë rrymë.

Rreth dy dekada më parë Kosova planifikonte të ndërtonte një termocentral të ri, Kosovën e Re, për ta shtuar prodhimin, por pas tërheqjes së Bankës Botërore nga projekti në vitin 2018 dhe dështimit të marrëveshjes me Countour Global në vitin 2020, ky projekt nuk u realizua.

Për Faruk Foniqin, ekspert i Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe i Teledetektimit (Remote Sensing), Kosova duhet ta synojë tashmë rehabilitimin nga varësia prej thëngjillit. Këtë kërkesë ai e arsyeton me pasojat për shëndetin publik, ndotjen e ajrit përmes lirim të grimcave të imëta dhe gazrave serrë, ndotjen e tokave bujqësore, ujërave nëntokësore etj. “Ky është një model i vjetruar i energjisë, që është shumë ndotës dhe i dëmshëm”, thotë Foniqi për REL-in.

Në linjë me këtë, në 2020-n Kosova u bë një nga vendet që nënshkroi Deklaratën për Agjendën e Gjelbër, duke u zotuar që deri në vitin 2050 të jetë plotësisht e dekarbonizuar - pra të prodhojë energji vetëm nga burimet e ripërtërishme si era, dielli dhe uji.

Por, e tërhequr nga projekti për një termocentral të ri të thëngjillit e pa projekte për rritje domethënëse të kapaciteteve të energjisë së ripërtërishme, Kosova aktualisht mbështetet në import për t'i mbuluar kërkesat. Çdo vit Kosova importon më shumë energji elektrike sesa që eksporton. Por ky dallim ishte më i dukshëm gjatë vitit 2025, kur sasia e eksportit nuk e kaloi atë të importit në asnjë muaj. Kjo gjë, sipas Dardan Abazit, nga

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), nuk është detyrimisht problematike. “Ne nuk jemi të vetëmjaftueshëm as për domate, as për patate, as për naftë. Nuk do të jemi as për energji”, thotë ai për REL-in. Sipas Abazit, problemi qëndron te varësia nga një prodhues i vetëm i energjisë: KEK-u.

Ai thotë se Kosova duhet të ecë përtej idesë që shteti ta prodhojë, shpërndajë e faturojë energjinë vetë. “Operatori për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) i ofron një avantazh të jashtëzakonshëm KEK-ut dhe asnjë furnizues tjetër nuk mund të hyjë realisht në treg”, thotë Abazi. Kështu, ai propozon një lloj liberalizimi të tregut të energjisë dhe integrim në tregun rajonal dhe evropian të energjisë, ku mund të arrihet një traktat për bashkëpunim me Shqipërinë.

Shqipëria, që prodhon energji vetëm nga burimet e ripërtërishme, është kryesisht e varur nga hidrocentralet.

Nga i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor, Kosova është më së shumti e varur nga qymyri. Foniqi, gjeograf, tregon se Kosova ka potencialin kryesor për prodhim të energjisë diellore nëpër zonat ku tokat bujqësore janë të një cilësie më të ulët. Ai sheh potencial edhe në prodhimin e energjisë përmes turbinave të erës, por thekson se zonat kryesore me kapacitet më të madh për prodhim janë ato ku shtrihen parqet kombëtare. Ai thotë se, megjithatë, kjo s'duhet ta pengojë zhvillimin e parqeve të erës.

Kosova ka realizuar vetëm një ankand përmes të cilit ka synuar realizimin e një parku solar me kapacitet prodhimi prej 100 megavatesh në orë, në Kramovik të Rahovecit, në jug të Kosovës. Projekti ende nuk është finalizuar.

Ndërkohë, janë finalizuar dy parqe të erës, në Kamenicë dhe në Bajgorë, ndërsa potencial është parë edhe në Çyçavicë, Zatriq, Budakovë dhe Kozhicë. Por, kjo nuk është e mjaftueshme për të ecur drejt dekarbonizimit më 2050, sipas Abazit nga INDEP-i. Ai kërkon që sa më shpejt të hartohet dhe miratohet në Kuvend Strategjia Dalëse nga Qymyri dhe të miratohet Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë.

Fillimisht, thekson ai, Qeveria e Kosovës duhet ta ketë një plan të qartë për afatet kohore drejt këtij synimi. “Nuk mund të mendojmë të shkojmë deri më 2050 me thëngjill dhe pastaj të zgjohemi një të hënë, në mëngjes, dhe të themi që nga sot s'do të përdorim thëngjill”, thotë Abazi.



Radio Evropa e Lirë ka dërguar pyetje për këtë çështje te Ministria e Ekonomisë, në kuadër të së cilës funksionon Departamenti i Energjisë, por nuk ka marrë përgjigje.

Tash e një vit Kosova funksionon me qeveri në detyrë, të udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit të vitit të kaluar i fitoi sërish LV-ja, me përkrahje mbi 50 për qind. Ministria e Ekonomisë ka subvencionuar faturat e energjisë elektrike për familjet që janë konsideruar të cenueshme dhe për ata që kanë kursyer, mirëpo statistikatat tregojnë se është një pjesë e vogël e konsumatorëve që shpenzojnë një pjesë të madhe të energjisë, pa e kursyer atë. Kjo ministri publikoi vetë disa të dhëna që tregonin se, në janar të vitit 2025, rreth 30 për qind e gjithë energjisë së konsumuar në Kosovë shpenzohej nga 9 për qind e konsumatorëve.

Problem kyç vazhdon të mbetet ngrohja gjatë muajve të dimrit, pasi që një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës varen nga ngrohja përmes energjisë elektrike. Sipas Abazit, kjo do të thotë se investimet shtetërore duhet fillimisht të fokusohen në eficiencë të energjisë dhe, pastaj, konsumatorët privatë të jenë edhe vetë të përfshirë në prodhim të energjisë.

Si mund të bëhet kjo? Për shembull, duke vendosur panele solare që transformojnë rrezet e diellit në energji elektrike, në kulmet e shtëpive. Hasim Gashi, nga kompania “Muqa Solar Company”, tregon se shumë konsumatorë që prodhojnë energjinë që shfrytëzojnë përmes paneleve solare në shtëpi, veçanërisht gjatë verës, paguajnë vetëm tarifën prej tri eurosh për kycje në rrjetin e energjisë. Ndërsa gjatë dimrit ai thotë se për

bizneset dhe individët me të cilët bashkëpunojnë, mbulueshmëria e konsumit përmes energjisë nga panelet solare sillet rreth 50 për qind.

Në vitet e fundit, kur çmimi i energjisë elektrike është rritur vazhdimisht, Ministria e Ekonomisë në Kosovë ka ofruar mbulimin e një pjese të kostos së instalimit të paneleve solare nëpër shtëpi. “Ka pasur diçka, por janë vlera tepër të vogla dhe jostimuluese. Edhe ka pasur disa pengesa gjatë marrjes së lejeve dhe licencave. Është punuar domethënë, por jo mjaftueshëm”, thotë Gashi për REL-in, duke theksuar pengesat burokratike në proces.

Sipas të dhënave të Zyrës së Bashkimit Evropian për Statistika (Eurostat), nga tetori i vitit të kaluar vetëm rreth 18 për qind e qytetarëve të Kosovës thonë se janë të mirinformuar me problemet që lidhen me ndryshimet klimatike. Edhe pse kjo është më e ulët se mesatarja e Bashkimit Evropian (23 për qind), qytetarët e Kosovës shprehen më të gatshëm për fokusimin e energjisë në burime të ripërtërishme.

Në mesin e burimeve të ripërtërishme të energjisë hyn edhe ajo e prodhuar nga hidrocentralet. Megjithatë, ky burim ka hasur në më shumë rezistencë nga banorët lokalë dhe ambientalistët.

Ankesat kryesore nxiten nga dëmet që u janë shkaktuar lumenjve dhe zonave përreth hidrocentraleve të ndërtuara. Rasti i hidrocentralit të ndërtuar në Deçan kishte shkuar deri në Gjykatë Kushtetuese për shkak të parregullsive në lejet e dhëna për operim.

Xhevat Ahmetaj, menaxher i përgjithshëm i hidrocentralit në Radac të Pejës, thotë se kapaciteti i Kosovës për të prodhuar energji nga hidrocentralet është i ulët. Megjithatë, ai shton se qytetarët

duhet ta kenë një gjë në mendje: që hidrocentralet duhet të lejohen të funksionojnë duke respektuar rregullat e operimit ashtu që të mbrohet mjedisi. Sipas tij, prodhimi i rrymës përmes hidrocentraleve duhet të shihet thjesht si “disa lopata më pak thëngjill në termocentrale”. “Në Kosovë shfrytëzohet kryesisht uji i të reshurave të shiut dhe kur shkrihet bora. Ne këta ujëra i shohim vetëm duke na vërshuar në qytete. Ai është uji që duhet të shfrytëzohet për prodhim të energjisë”, thotë Ahmetaj për REL-in.

Por, Foniqi, i cili ka analizuar të dhënat e reshjeve në Kosovë, thotë se shumica e lumenjve në vend nuk kanë rrjedhë konstante të mjaftueshme për prodhim të energjisë për shkak se reshjet tani janë sporadike. Për këtë arsye, ai thekson se fokusi duhet të jetë tek energjia solare dhe ajo e erës. “Hidroenergjinë mund ta shohim si burim ndihmës, jo si zgjidhje kryesore për sistemin energjetik. Ajo ka përparësi sepse prodhon energji me emetime të ulëta dhe ndihmon në stabilizimin e rrjetit, njëkohësisht Kosova është vend me burime ujore të ndjeshme dhe të paqëndrueshme”, thotë Foniqi.

Ai shton se si hidrocentrale mund të funksionojnë, në kapacitet të ulët, vetëm disa prej atyre që kanë nivel më të madh të ujit, si ai i Radacit. Për Abazin nga INDEP-i, e rëndësishme është që të ketë një strategji konkrete dhe investime adekuatë, pasi që, siç thotë, “sektori i energjisë nuk mund të zhvillohet përmes arnimeve”. “Jemi zhytur në varfëri energjetike dhe kjo vjen nga ngecja - qysh nga investimet në eficiencë, që do ta ulnin kërkesën, deri tek investimet në prodhim, që do ta decentralizonin prodhimin”, përfundon Abazi.

TEMPERATURAT -20 GRADË, RUSIA SHKELI ARMËPUSHIMIN DHE GODITI KIEVIN

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy, akuzoi Rusinë të martën se ka shkelur një marrëveshje me Donald Trump për të ndaluar sulmet ndaj sistemeve energjetike të Ukrainës gjatë dimrit të ashpër, ndërsa forcat ruse kryen sulme ajrore në shkallë të gjerë ndaj Kievit, në prag të bisedimeve trepalëshe që do të zhvillohen në Abu Dhabi.

Zelenskyy deklaroi se Moska kreu një sulm masiv dhe “të qëllimshëm” gjatë natës, në një kohë kur temperaturat në Kiev ranë në -20°C. Sipas tij, sulmi përfshinte një numër rekord prej 71 raketash balistike dhe rreth 450 dronësh, të përdorur për të shkatërruar infrastrukturën energjetike.

Më shumë se 1,000 ndërtesa banimi në Kiev mbetën pa ngrohje të martën.

Zelenskyy tha se Rusia ka shkelur një premtim që Trump e kishte paraqitur javën e kaluar si një kërkesë personale drejtuar Vladimir Putin për të ndaluar goditjet ndaj Kievit dhe “qyteteve të ndryshme” për një javë, për shkak të të ftohtit ekstrem. “Ai pranoi ta bënte këtë. Dhe duhet të them se ishte shumë e sjellshme,” kishte deklaruar presidenti amerikan të enjten.

Më pas, Kremlini njoftoi se armëpushimi do të zgjaste vetëm deri të dielën. Sipas Ukrainës, armëpushimi duhej të vazhdonte deri këtë të premte.

Zelenskyy tha se Rusia e kishte shfrytëzuar këtë pauzë të shkurtër në luftime për të grumbulluar armë. “Ose Rusia tani beson se një javë ka katër ditë të paplota në vend të shtatë, ose ata po mbështeten vetëm te lufta dhe po presin ditët më të ftohta të këtij dimri,” u shpreh ai.

“Ne besojmë se ky sulm rus shkel qartë atë që pala amerikane kishte diskutuar dhe duhet të ketë pasoja.”

Trump u tha gazetarëve se Putin kishte bërë një marrëveshje që kishte skaduar të dielën.

“Ishte nga e diela në të dielë, dhe pastaj u hap dhe ai i goditi fort mbrëmë,” tha Trump në Shtëpinë e Bardhë. “Ai e mbajti fjalën për atë ... ne do të pranojmë gjithçka, sepse atje është vërtet, vërtet ftohtë. Por ishte e dielë, dhe ai shkoi nga e diela në të dielë.”

I pyetur nëse ishte i zhgënjyer, Trump u përgjigj: “Unë dua që ai ta përfundojë luftën.”

Një raund i dytë bisedimesh mes Rusisë, Ukrainës dhe SHBA-së për t'i dhënë fund luftës pritet të zhvillohet të mërkurën dhe të enjten në Abu Dhabi. Raundi i parë, i mbajtur muajin e kaluar, nuk solli ndonjë përparim.



Gjatë një vizite në Kiev, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, akuzoi të martën Moskën se po përpiqet të “krijojë kaos për civilë të pafajshëm”. Ai tha se Zelenskyy ishte “absolutisht i gatshëm të luajë sipas rregullave” në bisedimet e kësaj jave, duke vënë në dyshim nëse rusët “janë seriozë”. Ai e quajti sulmin e natës “një sinjal vërtet të keq”.

Rutte e lavdëroi Trumpin si të vetmin person të aftë për të ndërmjetësuar një zgjidhje paqësore, gati katër vjet pas pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia. “Jini të sigurt se NATO qëndron me Ukrainën dhe është e gatshme ta bëjë këtë për vite me radhë. Siguria juaj është siguria jonë. Paqja juaj është paqja jonë,” i tha ai Zelenskyyt.

Banorë të Kievit raportuan shpërthime të forta duke filluar nga ora 1 e mëngjesit të martën, në sulme që shkaktojnë dëme në pesë zona të qytetit dhe plagosën të paktën gjashtë persona në kryeqytet. Alarmet ajrore qëndruan aktive për më shumë se pesë orë. Një sulm me dron në qytetin jugor Zaporizhzhia vrau dy adoleshentë dhe plagosi të paktën nëntë persona, sipas autoriteteve. “Përfitimi nga ditët më të ftohta të dimrit për të terrorizuar njerëzit është më i rëndësishëm për Rusinë sesa kthimi te diplomacia,” tha Zelenskyy. Ai u bëri thirrje

partnerëve përëndimorë të shtojnë furnizimin me raketa për sistemet e mbrojtjes ajrore, për të mbrojtur “jetën normale”. “Pa presion ndaj Rusisë, kjo luftë nuk do të përfundojë. Tani Moska po zgjedh terrorin dhe përshkallëzimin, dhe për këtë arsye nevojitet presion maksimal,” shkroi ai në rrjetet sociale.

Ndër infrastrukturën e goditura gjatë natës ishin edhe objektet që ngrohin ujin për shpërndarje në banesat e ukrainasve. “Qindra mijëra familje, përfshirë fëmijë, u lanë qëllimisht pa ngrohje gjatë kushteve më të ashpra dimërore, me temperatura që ranë deri në -25°C,” shkroi në platformën X ministri i energjisë i Ukrainës, Denys Shmyhal.

Një banorë e Kievit, Natalia Hlobenko, 35 vjeçe, tregoi se si vrapoi për të mbuluar djalin e saj 11-vjeçar të martën, para se një shpërthim të mbushte apartamentin e saj me xhamat të thyer.

“Ku është ky armëpushim?” tha Hlobenko mes lotësh, e mbështjellë në apartamentin e saj pa dritare.

Ukraina tha se sulmi kishte dëmtuar monumentin “Atdheu”, një memorial i epokës sovjetike i Luftës së Dytë Botërore. Statuja prej titani, 62 metra e lartë, që paraqet një grua me shpatë dhe mburojë me tridentin ukrainas, ngrihet mbi qytet dhe lumin

Dnipro, i cili është ngrirë.

“Është një akt njëkohësisht simbolik dhe cinik: shteti agresor godet një vend përkujtim i luftës kundër agresionit në shekullin XX, duke përsëritur krimet e tij në shekullin XXI,” shkroi në Facebook ministrja e kulturës, Tetyana Berezhna.

Bisedimet në Abu Dhabi zhvillohen mes raportimeve se Ukraina ka rënë dakord me aleatët e saj për një plan shumë-nivelësh për zbatimin e çdo armëpushimi me Rusinë. Plani u diskutua në dhjetor dhe janar nga zyrtarë ukrainas, evropianë dhe amerikanë.

Sipas Financial Times, që citon burime të përfshira në negociatë, një shkelje ruse e armëpushimit do të nxiste një reagim brenda 24 orësh, fillimisht me një paralajmërim diplomatik dhe më pas, nëse do të ishte e nevojshme, me veprime të ushtrisë ukrainase për të rivendosur armëpushimin.

Nëse luftimet do të vazhdonin pas 72 orësh, Ukraina dhe aleatët e saj do të kalonin në fazën e dytë, që përfshin një përgjigje ushtarake nga “koalicioni i vullnetarëve”, ku do të përfshiheshin edhe forca amerikane.

Sulmet e së martës u shtrinë në të gjithë Ukrainën. Në Kiev, 1,170 ndërtesa mbetën pa energji elektrike. Në qytetin

verilindor Kharkiv, kryebashkiaku Ihor Terekhov tha se infrastruktura energjetike ishte dëmtuar. Më shumë se 800 ndërtesa mbetën pa ngrohje, ndërsa uji u zbraz nga radiatorët për të shmangur ngrirjen në të ftohtin ekstrem.


“Qëllimi është i qartë: të shkaktohet shkatërrim maksimal dhe të lihet qyteti pa ngrohje në kushte të ftohti ekstrem,” shkroi Terekhov në Telegram.

Zëvendëskryeministri Oleksii Kuleba tha se 110,000 prona në Kharkiv kishin mbetur pa ngrohje pas sulmit.

Transmetuesi publik Suspilne raportoi se sulmet ruse kishin ndërprerë energjinë elektrike në dy qytete të rajonit të Kharkivit, Izium dhe Balakliia, si dhe kishin goditur dy ndërtesa banimi në qytetin verior Sumy.

Propagandistë rusë kanë festuar javët e fundit shkatërrimin e qëllimshëm të rrjetit energjetik të Ukrainës, një krim lufte. “E kemi kthyer Ukrainën në epokën e gurit. I ftohti i tmerrshëm po afrohet. Sistemi energjetik është jashtëzakonisht i ndjeshëm ndaj çekuilibreimeve,” deklaroi në televizionin shtetëror prezantuesi Vladimir Solovoyov.

Ai parashikoi se Kiev do të bëhej “një gropë gjigante ndotjeje”. / bota.al



FFK-ja SOT MBAN KUVENDIN ZGJEDHOR, ADEMI PRITET TË RIZGJEDHET PRESIDENT

PRISHTINË, 4 SHKURT - Sot (e enjte) do të mbahet Kuvendi Zgjedhor i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), me pikën e vetme të rendit të ditës, zgjedhjen e presidentit të ri të kësaj federate.

Presidenti aktual i FFK-së, Agim Ademi, është kandidati i vetëm në garë për t'u rizgjedhur edhe për një mandat të ri katërvjeçar për faktin se ka mbledhur shumicën e nënshkrimeve për ta drejtuar shtëpinë kryesore të futbollit në Kosovë.

Ademi është kryetar i FFK-së që nga viti 2018. Por, megjithëse nuk ka një kundërkandidat për kreun e FFK-së, Ademi është përballur me pengesa të mëdha

nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Përmes ministrit në detyrë, Hajrulla Çeku, MKRS-ja ka reaguar para disa ditësh pasi FFK-ja kishte caktuar 5 shkurtin datë për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor. Sipas MKRS-së, FFK-ja ende nuk i ka përmbushur obligimet e dala nga procesi i licencimit të vitit 2023, të dakorduara me UEFA-n, FIFA-n dhe vetë Ministrinë, përfshirë harmonizimin e Statutit me Ligjin për Sport dhe rregulloret përkatëse.

Lidhur me këtë çështje, në fund të muajit janar Çeku u kishte shkruar letër UEFA-s dhe FIFA-s kinse për parregullsitë në FFK për Kuvendin Zgjedhor të 5



shkurtit. Në të dy rastet, UEFA dhe FIFA i janë përgjigjur Çekut duke mos i dhënë të drejtë.

Në letrën e nënshkruar nga zyrtarë të lartë të FIFA-s e UEFA-

s është konfirmuar se FFK-ja ka harmonizuar statutin e saj në përputhje të plotë me kërkesat e dy institucioneve kryesore ndërkombëtare të sportit dhe

Ligjin për sportin, si dhe presin rizgjedhjen e Ademit në krye të FFK-së.

Nën drejtim të Ademit, Kombëtarja e Kosovës ka arritur rezultate historike, duke u kualifikuar për herë të parë në "play-off" për Kupën e Botës. Krahas kësaj, në mandatin e Ademit janë bërë investime të mëdha në infrastrukturën sportive.

Zyrtarë të UEFA-s dhe FIFA-s do të jenë të pranishëm në Kuvendin e sotëm për të siguruar që procesi zgjedhor të zhvillohet në përputhje me Statutin e FFK-së, si dhe me statutet, rregulloret dhe parimet përkatëse të FIFA-s dhe UEFA-s.

RIKTHIMI I XHUDISTËVE TË KOSOVËS NË SKENËN E MADHE TË PARISIT

PRISHTINË, 4 JANAR - Në fundjavë do të mbahet Grand Slami i Parisit, që llogaritet gara më e famshme e xhudos. Më të famshme këtë garë e bën numri shumë i madh i shikuesve, zakonisht mbi 15 mijë në bllloqet finale, arena madhështore "Bercy" dhe pjesëmarrja e xhudistëve më të mirë në botë. Gara mbahet përgjatë dy ditëve, të shtunën e të dielën, ndërsa aktualisht janë të evidentuar 518 pjesëmarrës nga 81 shtete të ndryshme. Kosova përfaqësohet

me pesë xhudiste dhe një xhudist. Erza Muminoviq garon në kategorinë deri 48 kilogramë, Distria Krasniqi e Fationa Kasapi në 52 kilogramë, Flaka Loxha në 57 kilogramë dhe Laura Fazliu në 63 kilogramë.

Te xhudistët, Akil Gjakova garon në kategorinë deri 73 kilogramë. Të gjithë paraqiten në tatami të shtunën.

Përveç Distrisë, Laurës dhe Akilit, që janë sportistët më të mirë që ka Kosova, në ekip janë edhe Erza, Fationa e Flaka që

fituan medalje fundjavën e kaluar në "European Open" në Sofje të Bullgarisë. Distria është bartësja e parë në kategorinë deri 52 kilogramë dhe pretendente për medalje. Asaj konkurrencë pritët t'i bëjnë gjermanja Mascha Ballhaus, spanjollja Ayumi Leiva Sanchez, francezja Amandine Buchard, hungarezja Reka Pupp, italiania Odette Giuffrida. Si zakonisht në luftë për medalje pritët të përfshihen edhe dy japonezet pjesëmarrëse. Distria e ka fituar

Grand Slamin e Parisit në vitin 2020, në vitin 2023 dhe në vitin 2024. Medalje të argjendta fitoi në vitet 2019 e 2022, kurse të bronzta në vitet 2017, 2018 e 2025. Pra i ka fituar plot tetë medalje në këtë ngjarje madhore. Laura Fazliu është bartësja e katërt në kategorinë deri 63 kilogramë dhe ajo e kërkon medaljen e parë në Grand Slamin e Parisit. Për shkak të mungesës së gjatë në gara, Akil Gjakova ka rënë në renditje dhe nuk është bartës në



Paris. Ai nuk ka garuar që nga qershori i vitit të kaluar për shkak të një lëndimi. Akili ka ngadhënjyer në Paris në vitin 2018. Vjet ishte i dyti, e në vitin 2024 i treti.

JOAN LAPORTA JEP DORËHEQJE NGA BARCELONA

BARCELONË, 4 SHKURT - Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, ka konfirmuar se do të japë dorëheqjen nga pozicioni i tij të hënën, më 9 shkurt 2026, për ta nisur zyrtarisht kandidaturën e tij për rizgjedhje në votimin presidencial të planifikuar për të dielën, më 15 mars 2026. Në një deklaratë të publikuar përmes kanaleve zyrtare të klubit, Laporta ka shpjeguar se,

në përputhje me statutet e klubit, ai dhe disa anëtarë të bordit duhet të japin dorëheqje për të qenë kandidatë. Një grup tjetër drejtuesish, i udhëhequr nga nënkryetari Rafael Yuste, do të mbetet në detyrë për t'i menaxhuar punët e përditshme dhe për ta mbikëqyrur procesin zgjedhor. Laporta ka shprehur entuziazëm për fushatën e ardhshme, duke e përshkruar



veten si "i emocionuar dhe energjik" dhe duke shpresuar për një pjesëmarrje të lartë, një proces zgjedhor model, të zhvilluar me normalitet dhe

korrektësi ndërmjet të gjithë anëtarëve të Barcelonës. Ai ka pranuar kandidaturat e tjera të shpallura ose të mundshme, përfshirë Victor Font, Marc Ciria, Xavi Vilajoana dhe Joan Camprubi Montal dhe i bëri thirrje që të paraqesin propozimet e tyre me respekt. Për menaxhimin tranzicional, ai ka theksuar se anëtarët e mbetur të bordit do t'i mbikëqyrin zgjedhjet për të

siguruar që ato të shndërrohen "në një festë" për anëtarësinë. Duke folur për ofertën e klubit për ta mirëpritur finalen e Ligës së Kampionëve 2029 në "Camp Nou" e rinovuar, Laporta ka theksuar se puna institucionale vazhdon pa ndërprerje, duke shtuar se shpreson që propozimi të shpallet fitues dhe se Barcelona të mund të marrë pjesë në finalen nëse i jepet organizimi.

Rrahmani do ta mbyllë karrierën te Napoli

NAPLES, 4 SHKURT - Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, duket se tashmë ka vendosur se ku do ta përfundojë karrierën si futbollist aktiv. Rrahmani pritët ta mbyllë karrierën me fanellën e Napolit, pasi është pajtuar ta rinovojë

kontratën, e cila do t'i skadojë kur të mbushë 35 vjet. Me rinovimin e kontratës aktuale që në vitin e ardhshëm, Rrahmani do të mbetet te skuadra e Napolit deri në verën e vitit 2029. 31-vjeçari tashmë është shndërruar

në lider të mbrojtjes te Napoli, ekip me të cilin ka fituar dy tituj kampionë të Italisë. Ai është pjesë e Napolit prej vitit 2020 kur iu bashkua nga Verona, ndërsa këtë sezon ka shënuar 1 gol në 19 paraqitje në të gjitha garat.

Gjithashtu, Rrahmani është rikuperuar nga lëndimi që e detyroi të mungojë në katër ndeshjet e fundit të Napolit dhe do të jetë startues në ndeshjen kampionale kundër Genoas që zhvillohet këtë fundjavë.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Domus Lounge” SH.P.K. pronar Muhamet Barja me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812314990 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Domus Lounge” D.O.O. Muhamet Barja Vuqitern donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812314990 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Domus Lounge” L.L.C. with owner Muhamet Barja with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812314990 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Global Call Center” L.L.C. Gjilan me pronar Arbër Zeneli ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812289991 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Global Call Center” L.L.C. Gjilan, Arbër Zeneli donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812289991 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Global Call Center” L.L.C. Gjilan, Arbër Zeneli, has come to the decision to quit its business: 812289991 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin “Plastika” Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot. 25/8313/MMPHI/707/DMM, për veprimtarinë: Fabrikë e riciklimit të mbeturinave të plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës, Parku i Biznesit, Korroticë e Epërme, Glllogoc, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 27.02.2026, në ora: 10:30, në hapësirat e Administrative te Kompanisë në Parkun e Biznesit, Korroticë e Epërme, Komuna Glllogoc, do të organizohet debat publik nga operatori “Plastika” Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr. Prot. 25/8313/ MMPHI/ 707/ DMM, për veprimtarinë: Fabrikë e riciklimit të mbeturinave të plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës, Parku i Biznesit, Korroticë e Epërme, Glllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

ID: 880 8777 3525

Passcode: 12345678

Linku për Zoom Meeting:

<https://us05web.zoom.us/j/88087773525?pwd=Sx8O5SfWjEL47j28swqrb9ZtFqLsr0.1>

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=Plastika>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

“Plastika” Sh.p.k.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Zahrije Makshana shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Vëllezërit Frashëri” Drenovc Rahovec nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Rexhep Rexhepishpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Zenel Sadiku” Babaj Bokes Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Beqir Deva shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Automekanik në Gjakovë.

- Dafina Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit XI , XII shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Nazmi Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

- Mesude Dogani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Mati Logoreci” Prizren.

“FAR” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810155722.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.




Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A. shpall këtë:

KONKURS I JASHTËM

Titulli i vendit të punës: Mirëmbajtës/e, një (1);
Numri i referencës: 07;
Lartësia e pagës mujore: 430.00 € (katërqind e tridhjetë euro) BRUTO.



Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi kryesore:

- Mirëmbajtja e nivelit të lartë të pastërtisë në të gjitha hapësirat e ndërmarrjes;
- Pastrimi i mjeteve të punës pas përdorimit të tyre;
- Sipas nevojës kryen dhe detyra të tjera të caktuara nga udhëheqësi.

Kriteret dhe kualifikimet profesionale:

- Shkollim fillor;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi;
- Njohuri në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të mirëmbajtjes;
- Kujdesi për higjinën e Ndërmarrjes.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë online dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin për punësim (i cili gjendet në faqen zyrtare prishtinaparking.net në rubrikën "Konkurset")
- Dëshminë e shkollimit;
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional) opsional;
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit.

Kontratë pune gjashtë (6) muaj pune provuese, me mundësi vazhdimi për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në e-mail apliko@prishtinaparking.net, ku të gjitha dokumentet duhet të ngarkohen sipas kërkesave të përcaktuara përmes këtij konkursi. Pas aplikimit të suksesshëm, aplikantët do të njoftohen me e-mail konfirmues. Nëse aplikanti nuk pranon e-mail konfirmues pas aplikimit, i njeiti udhëzohet të kontaktojë numrin kontaktues 038/224-228 apo përmes e-mail adresës apliko@prishtinaparking.net. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen ndërsa aplikacionet e mangëta do të refuzohen.

MËNYRA E VLERËSIMIT DHE KRITERET E POENTIMIT:

Vlerësimi bëhet përmes testimit me shkrim dhe intervistimit, ku kalueshmëria është arritja e së paku 55 pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik. Testimi me shkrim vlerësohet deri në 70 pikë, intervistimi vlerësohet deri në 20 pikë dhe CV (jetëpërshkrimi) i kandidatit vlerësohet deri në 10 pikë.

Kalendari i përafërt i përfundimit të procedurave të konkursit:

Procedurat e konkursit parashihen të procedojnë si në vijim: testimi me shkrim – brenda 32 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit, intervistimi – brenda 42 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit dhe njoftimi final – brenda 47 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit. Këto afate vlejnë nëse nuk ka ankesa.

Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data 05.02.2026 deri më 19.02.2026, deri në ora 23:59.

Adresa: Rr. "Musa Tolaj", Objekti "Donika 2", Lakrishtë,
Prishtinë, 10000, Kosovë
Telefon: +383 (0) 38 224 228
Email: info@prishtinaparking.net




Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Na temelju odredbi članka 8. Zakona br. 03/L-212 o radu i članka 4. Administrativne upute (MFPT) br. 01/2024 o reguliranju postupaka javnog natječaja u javnom sektoru, Lokalno javno poduzeće „Prishtina Parking” d.d. objavljuje:

VANJSKI NATJEČAJ

Naziv radnog mjesta: Održavatelj /ica, jedan (1)
Referentni broj: 07;
Mjesečna bruto plaća: 430.00 € (četiristo trideset eura) BRUTO.



Opis glavnih zadataka i odgovornosti:

- Održavanje visoke razine čistoće u svim prostorijama poduzeća;
- Čišćenje radnih sredstava nakon njihove uporabe;
- Prema potrebi obavlja i druge zadatke koje odredi nadređeni.

Kriteriji i stručne kvalifikacije:

- Osnovno obrazovanje;
- Posjeduje dobre komunikacijske vještine;
- Poznavanje korištenja alata i opreme za održavanje;
- Briga o higijeni poduzeća.

Dokumentacija koju je potrebno dostaviti:

Kandidat/kinja za ovu poziciju mora elektroničkim putem dostaviti sljedeće dokumente:

- Prijavu za zaposlenje (koja se nalazi na službenoj stranici prishtinaparking.net u rubrici „Natječaji”);
- Dokaz o obrazovanju (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (mirovinski fond) – opcionalno;
- Potvrdu da se ne vodi kazneni postupak (ne stariju od 6 mjeseci);
- Izvadak iz matične knjige rođenih;
- Kopiju osobne iskaznice

Radni odnos se zasniva na probni rad od šest (6) mjeseci, s mogućnošću nastavka na neodređeno vrijeme u slučaju pozitivne ocjene radne uspješnosti.

Prijava se vrši isključivo elektroničkim putem na e-mail adresu: apliko@prishtinaparking.net, gdje se svi dokumenti moraju učitati sukladno zahtjevima iz ovog natječaja. Nakon uspješne prijave, kandidati će biti obaviješteni putem potvrđujuće e-pošte. Ako kandidat ne primi potvrdu, treba kontaktirati broj 038/224-228 ili e-mail apliko@prishtinaparking.net. Prijave pristigle nakon roka neće se razmatrati, a nepotpune prijave bit će odbijene.

NAČIN VREDNOVANJA I BODOVANJA

Vrednovanje se vrši putem pismenog testa i intervjuja. Minimalan prag prolaznosti iznosi 55 bodova iz svih faza. Pismeni test: do 70 bodova, Intervju: do 20 bodova, Životopis (CV): do 10 bodova.

Okvirni kalendar završetka postupka:

Pismeni test: unutar 32 dana od dana objave natječaja; Intervju: unutar 42 dana, Konačna obavijest, unutar 47 dana (Navedeni rokovi vrijede ako nema žalbi.)

Natječaj je otvoren 15 dana, od 05.02.2026, do 19.02.2026, do 23:59 sati

Adresa: Rr. "Musa Tolaj", Objekti "Donika 2", Lakrishtë,
Prishtinë, 10000, Kosovë
Telefon: +383 (0) 38 224 228
Email: info@prishtinaparking.net

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L